

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE DPAP 2023

Tërë-mujori i parë

Nr. Rendor	Data	Kërkesa	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	06.01.2023	<p>1. Sa mësues u japin mësim nxënësve me nevoja të veçanta në të gjithë vendin?</p> <p>2. Sa nxënës të regjistruar në sistemin arsimor shqiptar kanë nevoja të veçanta?</p> <p>3. A marrin ata mësim në klasa të zakonshme, apo vetëm në qendra?</p> <p>4. Cilat janë masat e marrë nga Ministria e Arsimit për t'u ardhur në ndihmë arsimimit të këtij target-grupi të nxënësve?</p>	17.01.2023	<p>Numri i mësuesve ndihmës për vitin shkollor 2022-2023 në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore është 1565.</p> <p>Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore për vitin shkollor 2022-2023 është 3981.</p> <p>Nxënësit me aftësi të kufizuara ndjekin procesin mësimor si në institucionet e arsimit special, ashtu dhe në institucionet arsimore të zakonshme.</p> <p>Ministria e Arsimit dhe Sportit për të siguruar një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës si dhe për zhvillimin e potencialit intelektual, socio-emocional, zhvillimor dhe fizik të nxënësve ka vënë në mbështetje të tyre mësuesit ndihmës të cilët në bashkëpunim me mësuesin lëndor/kujdestar dhe psikologun e shkollës hartojnë planin edukativ individual (PEI) duke planifikuar ndërhyrjet për të plotësuar nevojat prioritare të nxënësve.</p> <p>Gjithashtu në mbështetje të nxënësve me aftësi të kufizuara janë hapur 150 klasave burimore nëpërmjet të cilave sigurohet mbështetja dhe mundësia e arsimit për nxënësit. Klasat burimore, janë ambiente brenda shkollës të cilat kanë rezultuar shumë efeciente për të përmirësuar aftësitë e tyre dhe për të nxitur aftësitë e të nxënët nëpërmjet mjeteve që ato disponojnë.</p>	E plotë	jo
2	10.01.2023	<p>1. Sa nxënës të infektuar me HIV janë të regjistruar në sistemin arsimor shqiptar?</p> <p>2. Si arrijnë këta nxënës të marrin mësimet në klasa? (Janë të njohur nga mësuesit dhe komuniteti i prindërve?)</p> <p>3. Sa prej nxënësve të infektuar me HIV janë regjistruar gjatë vitit shkollor 2022-2023? Sa prej tyre u përkasin klasave të para?</p> <p>4. Sa ligjerime vjetore mbahen në shkollat fillore dhe të mesme ku nxënësit njihen me virusin HIV dhe pasojat e tij në shëndet?</p>	23.01.2023	<p>Për pyetjen "Sa ligjerime vjetore mbahen në shkollat fillore dhe të mesme ku nxënësit njihen me virusin HIV dhe pasojat e tij në shëndet?", ju informojmë se: Këto tema trajtohen në modulën Edukimi seksual si aftësi për jetën si dhe në lëndën e biologjisë në tematikën e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme në AMU dhe AML duke zënë vend të veçantë. Edhe në programet e Edukimit fizik sporte dhe shëndeti. Gjithashtu në 1 dhjetor shkollat bëjnë aktivitet sensibilizues lidhur me këtë temë.</p> <p>Këto tema mund të konsultohen në programet lëndore të publikuara në faqen zyrtare të ASCAP, linqet si më poshtë: https://ascap.edu.al/ep-content/uploads/2018/09/MODUL-educimi-seksual-si-aftesi-per-jeten-edlirasina.pdf; https://ascap.edu.al/Biblioteka/3Programe%20Lendore/2Programet%20e%20Arsimit%20Baze%20Kurrikula%20e%20Re/Programet%20e%20Klases%203%20dhe%200%208/Programet%20e%20klases%20se%208/Biologji1.pdf.</p>	pjeserisht deleguar MSHMS	jo
3	16.01.2023	<p>Sa është numri i nxënësve në sistemin parauniversitar dhe atë 9-vjeçar në vendin tonë?</p> <p>Sa shkolla nëntë vjeçare, të bashkuara dhe të mesme, të mesme profesionale, ka vendi ynë?</p> <p>Sa tekste shkollore për lëndën e historisë janë të miratuara për ciklin 9 vjeçar dhe të mesëm?</p> <p>Si funksionon procesi i këtyre teksteve?</p> <p>Si kontrollohet përmbajtja dhe informacionet e teksteve historike?</p> <p>A ka ndër marrë Ministria kontrolle për verifikimin e teksteve shkollore?</p> <p>A ka iniciuar Ministria, a është pjesë e proceseve të rishikimit të teksteve historike?</p> <p>Çfarë bashkëpunimi keni me autoritetet e Republikës së Turqisë për rishikimin apo vlerësimin e teksteve shkollore të lëndës së historisë?</p> <p>Çfarë parashikon kontraktin vendim i 2 mars 2021 që u botua në Fletoren Zyrtare për marrëveshjen e bashkëpunimit midis Këshillit të Ministrave dhe qeverisë turke për bashkëpunimin në fushën e arsimit, e cila përfshin ndër të tjera shkëmbimin e përvojave midis dy vendeve për përmirësimin e materialeve arsimore, një kërkesë e hershme kjo e qeverisë së Turqisë, sidomos për trajtimin e pushtimit osman në tekstet shkollore.</p> <p>Në çfarë faze është zbatimi i këtij vendimi aktualisht?</p> <p>A keni pasur ankesa për tekste të caktuara të lëndës së historisë? Nëse po na informoni për to.</p>	30.01.2023	Percjelle infomacioni i kërkuar	E plotë	jo
4	22.02.2023	Ankesa per procedurat e provimit te shtetit nga QSHA	22.02.2023	Percjelle per trajtim Qendres se Sherbimeve Arsimore	Deleguar QSHA	jo
5	22.02.2023	Raport se sa maturantë kanë ngelur në vitin shkollor 2021-2022, dhe në qoftë se është mundësia, më duhet dhe një informacion në lidhje me mungesat e nxënësve, pra sa nxënës janë përjashtuar për shkak të mungesave ose të kenë ngelur	06.03.2023	<p>Nga informacionet e data bazës së QSHA, për të dyja sesionet e Maturës Shtetërore, rezultun se:</p> <p>Në provimin D1 (Gjuhë Shqipe dhe Letërsi) numri i maturantëve të cilët janë vlerësuar me notën 4.00 është 115.</p> <p>Në provimin D2 (Matematike) numri i maturantëve të cilët janë vlerësuar me notën 4.00 është 703.</p> <p>Në provimin D3 (Gjuhë e huaj) numri i maturantëve të cilët janë vlerësuar me notën 4.00 është 260.</p> <p>Në provimin Z (Lëndë me zgjedhje) numri i maturantëve të cilët janë vlerësuar me notën 4.00 është 482.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar informon se:</p> <p>Numri i maturantëve të ngelur për shkak të mungesave është 654.</p> <p>Numri i maturantëve të ngelur për shkak të notave është 356.</p> <p>Gjithsej 1010 maturantë kanë përsëritur klasën XII në vitin shkollor 2022-2023.</p>	E plotë	jo

6	24.02.2023	<p>1. Sa mësues kemi aktualisht në sistemin arsimor?</p> <p>2. Sa vende vakante ka në mësuesi?</p> <p>3. Sa mësues kemi në listat e pritjeve për të hyrë në punë?</p> <p>4. Në një deklaratë me datë 17 shkurt për mediat ministrja Kushi deklaroi që: "Të diplomuarit në një fushë të ngjashme ose të përafërt me fushën e mësuesisë, si inxhinieri, ekonomi, arte, gjuhësi, përkthim, së shpejti do të kenë mundësi që të ushtrojnë profesionin e mësuesit pasi të kenë kryer formimin e nevojshëm psiko-pedagogjik."</p> <p>5. A keni bërë një studim se sa mësues kemi në këto fusha, e sa do kemi në bazë të kësaj nisme?</p> <p>6. Në bazë të studimit tuaj a nuk e dëmton kjo cilësinë e arsimit në Shqipëri?</p> <p>7. Si do merret statusi i mësuesit, nëpërmjet një projekt-ligji, me udhëzim apo me ndonjë element tjetër ligjor?</p>	06.03.2023	Përcjellë përgjigje mbi kërkesat	E plotë	jo
7	09.03.2023	<p>1.A ka nisur puna për ekokampusin në Sarandë?</p> <p>2.Nese jo, përse është zvarritur projekti?</p> <p>3.Ju lutem na vini në dispozicion projektin për Ekokampusin e Sarandës?</p> <p>4.Sa eshte vlera e projektit për Ekokampusin në Sarandë?</p> <p>5.Kur parashikohet të nisë, (nëse nuk ka nisur) dhe kur do të përfundojë?</p> <p>6.Me çfarë financimi do të realizohet projekti?</p>	16.03.2023	Deleguar Bashkisë Sarandë	E plotë	jo
8	17.03.2023	<p>Nisur nga të dhënat që kemi marrë nga Avokati i Popullit, rezultoi se ka patur raste kur mësues në rrethe të Shqipërisë janë vënë nën presion për tu bërë pjesë e fushatave elektorale madje ka raste sipas avokatit të popullit, që janë pushuar nga puna. A keni ju dijeni për raste të tilla?</p> <p>A ka ankesa pranë digasterëve të ministrisë së Arsimit për presione të mundshme që ushtrohen ndaj mësuesëve nga parti të ndryshme?</p> <p>Nëse po, cilat janë masat që ju keni marrë?</p>	29.03.2023	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, sqaron se:</p> <p>Nuk disponon të dhëna që mësues të jenë vënë nën presion për tu bërë pjesë e fushatave elektorale ose që janë pushuar nga puna. Pranë institucioni tonë, deri më sot nuk janë paraqitur ankesa për presione të mundshme që janë ushtruar ndaj mësuesëve nga parti të ndryshme.</p> <p>Për të evituar çdo rast të mundshëm presioni ndaj mësuesëve apo stafëve të punonjësve, në zbatim të ligjit nr. 9131, date 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", ligjit nr. 90/2012, "Per organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", Kodit Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë, Vendimit nr. 9 të KQZ "Për rregullat e raportimit te veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimeve të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.99, date 27.2.2019 "Per krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme te arsimit parauniversitar", shkresës nr. 158 prot., datë 15.02.2023 te Komisionarit për Mbrojtjen e Shërbimit Civil"</p>	E plotë	jo
9	27.03.2023	Numri total i mesuesve te lendës "Qytetaria 5-8".	06.04.2023	Përcjellë informacioni i kërkuar	E plotë	jo